



ALBGAS sh.a.
OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT NATYROR
ZYRTARI I PËRPUTHSHMËRISË

Nr. _____ Prot

Tiranë, më / /2019

RAPORTI VJETOR I PËRPUTHSHMËRISË
2018

**Mbi zbatimin e Programit të Përputhshmërisë në Sektorin e Gazit
Natyror nga Albgaz Sh.a.**

ALBGAS Sh.a
Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror
Njësia Administrative Nr. 5, Rruga e Kosovarve,
Pallati Ndër Pro, Tiranë, Shqipëri
www.albgaz.al
NUIS: L71306034U

RAPORTI VJETOR I PËRPUTHSHMËRISË
2018

**Mbi zbatimin e Programit të Përputhshmërisë në Sektorin e Gazit
Natyror nga Albgaz Sh.a.**

Ky raport është përgatitur në bazë të informacionit që i është vënë në dispozicion nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Shpërndarjes së Gazit Natyror ALBGAZ Sh.a., në zyrën e Zyrtarit të Përputhshmërisë së Shoqërisë gjatë përbushjes së përgjegjësive të tij në 2017-2018.

Në zbatim të kërkesave të nenit 47, nenit 16 pika 7 të Ligjit 102/2015 datë 23.09.2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar, si dhe vendimit të ERE nr.77, datë 26.05.2017, raporti vjetor do të publikohet në dy gjuhë në faqen zyrtare të internetit të Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Gazit - ALBGAZ Sh.a (www.albgaz.al) brenda pesë ditëve nga paraqitja e tij në gjuhën shqipe Entit Rregullator të Energjisë (ERE). Raporti duhet të ketë përfunduar deri më 31 mars të çdo viti.

Përgatiti:

Elvis Ponari MBA, MSc

Zyrtari i Përputhshmërisë

Email: elvis.ponari@albgaz.al

Data e publikimit: 25 Mars 2019

SHKURTIME DHE PËRKUFIZIME

ALBGAZ SH.A.: Operatori i Kombinuar i Sistemit të Transmetimit dhe Shpërndarjes së Gazit Natyror i krijuar me Vendimin Nr. 848, datë 7.12.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive “ALBPETROL” sh.a. dhe “ALBGAZ” sh.a.”, i ndryshuar.

ALBPETROL SH.A.: Shoqëria publike e kërkimit Prodhimit të Naftës dhe Gazit krijuar me Vendimin Nr. 756, 26.11.1998 të Këshillit të Ministrave “Për ristrukturimin e Albpetrol sh.a.”, plotësuar me Vendimin Nr. 848, datë 7.12.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive “ALBPETROL” sh.a. dhe “ALBGAZ” sh.a..

ERE: “Enti Rregullator i Energjisë” ose “ERE” është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin për sektorin e gazit natyror dhe ligjin për sektorin e energjisë elektrike.

OSSH/DSO: “Operator i Sistemit të Shpërndarjes” është personi juridik, i cili kryen funksionin e shpërndarjes dhe është përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe, nëse është e nevojshme, zhvillimin e sistemit të shpërndarjes në një zonë të caktuar dhe, ku është e zbatueshme, ndërlidhjen me sisteme të tjera, si edhe për garantimin e mundësive afatgjata të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e gazit;

OST/TSO: “Operator i Sistemit të Transmetimit” është personi juridik, që kryen veprimtarinë e transmetimit dhe është përgjegjës për operimin, sigurimin e mirëmbajtjes dhe, nëse është e nevojshme, zhvillimin e sistemit të transmetimit në një zonë të caktuar dhe, ku është e zbatueshme, ndërlidhjen e tij me sistemet e tjera, si dhe për garantimin e mundësive afatgjata të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për transportin e gazit.

Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror: “Operator i kombinuar i gazit natyror” konsiderohet kur e njëjta shoqëri e gazit natyror mund të licencohet për të kryer veprimtarinë e transmetimit, shpërndarjes, operatorit të impianteve të GNL-së dhe/ose të impianteve të depozitimit, me kusht që të respektojë kërkesat për ndarjen për çdo operator sistemi, sikurse parashikohet nga ky ligj, dhe të jetë i pavarur nga shoqëritë që kryejnë ndonjë nga funksionet e prodhimit, furnizimit apo tregtimit.

“ENTSO-G”: është Rrjeti European i Sistemit të Operatorëve të Transmetimit të Gazit

MIE: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

GNL: “Gaz Natyror i Lëngshëm” është gazi metan, përshirë gazin shoqëruar, si dhe të gjitha hidrokarburet që janë në gjendje të gaztë, në kushte atmosferike normale, i cili, përfshin edhe GNL-në, biogazin ose lloje të tjera gazi, që transmetohen dhe shpërndahen në sistemin e tubacioneve.

“Programi i përputhshmërisë” është program i hartuar nga operatorët e sistemit dhe i miratuar nga ERE, në të cilin përcaktohen masat e nevojshme që do të ndërmarrë operatori për garantimin e sjelljes jodiskriminuese, si dhe metodat që do të zbatohen për monitorimin e zbatimit të tij.

“Zyrtari i përputhshmërisë” është një person fizik ose juridik, i pavarur, i përcaktuar nga operatori i sistemit, me miratimin paraprak të ERE-s, i ngarkuar me monitorimin dhe raportimin mbi zbatimin e programit të përputhshmërisë.

Përmbajtja

PJESA E PARË	6
1. Hyrje	6
2. Kompania ALBGAZ sh.a.	7
2.1. Forma ligjore dhe statusi i kompanisë OST	9
2.2. Filialet e OST dhe/ose kompanive të tjera ku OST është aksionar	9
2.3. Struktura e shoqërisë ALBGAZ sh.a.	10
3. Programi i Përputhshmërisë – Metodologjia e kontrollit	16
4. Katër parimet themelore që qeverisin aktivitetin e ALBGAZ sh.a.	18
4.1. Ndarja dhe pavarësia e OST	19
4.1.1. Ndarja e OST	19
4.1.2. Pavarësia drejtuese e OST	19
4.1.3. Pavarësia funksionale dhe Vendimarrëse e OST	20
4.2. Përjashtimi i sjelljes diskriminuese	21
4.2.1. Aksesit në sistemin e transmetimit	22
4.2.2. Konkurrenca dhe marrëdhëniet komerciale	22
4.2.3. Konflikti i interesit	22
4.3. Politika e informacionit të kompanisë OST	22
4.3.1. Sigurimi i informacionit	22
4.3.2. Konfidencialiteti i informacionit	23
4.3.3. Informacioni publik	23
4.4. Zbatimi i Programit të Përputhshmërisë	23
4.4.1 Karakteri detyrues i Programit të Përputhshmërisë	23
4.4.2 Monitorimi i zbatimit të Programit të Përputhshmërisë	23
4.4.3 Raportimi për zbatimin e Programit të Përputhshmërisë	24
PJESA E DYTË	24
5. Rekomandimet e Zyrtarit të Përputhshmërisë	24
PJESA E TRETË	26
6. Përfundime	26

PJESA E PARË

1. Hyrje

Në mbështetje të ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar, (botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 178, datë 15.10.2015), në zbatim të kërkesave të nenit 47, Programi i Përputhshmërisë është miratuar nga Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) me Vendim Nr. 77, datë 26.05.2017 “Mbi miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror”.

Me Vendimin Nr. 233, datë 16.10.2018, “Mbi miratimin e “Kërkesave minimale për zyrtarin e përputhshmërisë, kriteret profesionale si dhe kriteret e tjera përzgjedhëse” dhe miratimin paraprak të Zyrtarit të Përputhshmërisë së OST të Gazit Natyror”, Këshilli Mbikqyrës i shoqërisë ALBGAZ Sh.a., Operator i Kombinuar i Gazit Natyror, krijuar me Vendimin Nr. 848, datë 7.12.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive “ALBPETROL” sh.a. dhe “ALBGAZ” sh.a.”, emëroi Z. Elvis Ponari MBA, MSc, në pozicionin e Zyrtarit të Përputhshmërisë të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST), me miratimin paraprak të Entit Rregullator të Energjisë sipas Vendimit Nr. 223, date 16.10.2018, “Mbi miratimin e "Kërkesave minimale për zyrtarin e përputhshmërisë, kriteret profesionale si dhe kriteret e tjera përzgjedhëse" dhe miratimin paraprak të zyrtarit të përputhshmërisë së OST të gazit natyror”.

Ky raport vjetor u përpunua nga Zyrtari i Përputhshmërisë si kërkesë ligjore e parashikuar nga Vendimi i Bordit të ERE Nr. 78, datë 26.05.2017 “Mbi miratimin e kontratës për Ofrimin e Shërbimeve të Zyrtarit të Përputhshmërisë në sektorin e gazit natyror”. Në këtë raport vjetor përputhshmërie parashtrohet monitorimi dhe mbarëvajtja e procesit sipas Programit të Përputhshmërisë të miratuar nga EREme Vendim Nr. 77, datë 26.05.2017 “Mbi miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror”.

Në funksionimin e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. gjatë vitit 2018 ka ndodhur një ndryshim i rëndësishëm përse ka të bëjë me ndryshimin e Autoritetit publik, që përfaqëson shtetin si pronar të 100% të aksioneve të shoqërisë “ALBGAZ” sh.a., pasi referuar VKM Nr. 108, datë 23.2.2018, “Për një ndryshim në Vendimin Nr. 848, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive “ALBPETROL” sh.a. dhe “ALBGAZ” sh.a.”, është përcaktuar që Autoritetit publik, që përfaqëson shtetin si pronar të 100% të aksioneve të shoqërisë “ALBGAZ” sh.a.do të jetë ministria përgjegjëse për infrastrukturën.

Në fushën e veprimtarisë së shoqërisë ALBGAZ sh.a. që është sektori i energjisë, gjatë vitit 2018 janë miratuar edhe dy nga dokumentet më të rëndësishme për sektorin e energjisë dhe specifikisht të sektorit të gazit duke përfshirë direkt objektin e veprimtarisë së shoqërisë ALBGAZ sh.a., që janë:

- Miratimi i Strategjisë Kombëtare të Energjisë për periudhën 2018 – 2030, miratuar me Vendimin Nr. 480, datë 31.7.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë për periudhën 2018– 2030”.
- Miratimi i Master Planit të Gazit Natyror për Shqipërinë, miratuar me Vendim Nr. 87, datë 14.2.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”.

Shoqëria “ALBGAZ” sh.a. pasi është certifikuar nga ERE me Vendim i Bordit të ERE Nr. 179, datë 8.11.2017 “Mbi certifikimin e shoqërisë Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror, ALBGAZ sh.a.” dhe është licencuar si Operator i Transmetimit të Gazit Natyror me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 188, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë ‘ALBGAZ’ sh.a., në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, gjatë vitit 2018 ka patur edhe një Vendim tjetër të ERE për ndryshim në Vendimin për licencimin me Vendimin e bordit të ERE-s Nr. 178, datë 20.8.2018 “Për një ndryshim në Vendimin e bordit të ERE-s Nr. 188, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë ‘ALBGAZ’ sh.a., në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”.

Shoqëria “ALBGAZ” sh.a. gjatë vitit 2018 megjithë aktivitetin mjaft minimal në transmetimin e gazit natyror, ka patur një aktivitet konkret përsa i përket rolit të saj si kompania publike e transmetimit të gazit natyror. Gjatë vitit 2018 shoqëria “ALBGAZ” sh.a. ka hyrë në marrëdhënie bashkëpunimi me shoqërinë italiane SNAM S.p.A. për krijimin e shoqërisë së përbashkët “ALBANIAN GAS SERVICE COMPANY” sh.a., e cila ka nënshkruar me shoqërinë Trans Adriatic pipeline AG (TAP AG) një Marrëveshje për shërbimin e mirëmbajtjes së Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP) në territorin shqiptar.

Marrëveshja për krijimin e ndërmarrjes së përbashkët është miratuar me Vendimin Nr. 609, datë 17.10.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e marrëveshjes së ndërmarrjes së përbashkët nga dhe ndërmjet “Snam” S.p.a. dhe “ALBGAZ” sh.a., lidhur më 11 qershor 2018”, pasi më parë ka qenë miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 164, datë 21.3.2018, “Për negocimin me partnerin privat të përzgjedhur nga shoqëria “ALBGAZ” sh.a. për krijimin e një shoqërie të përbashkët për mirëmbajtjen e rrjetit të transmetimit, të ndërtuar nga *Trans Adriatic Pipeline AG* në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

Raporti vjetor 2018 përfshin masat më të rëndësishme që lidhen me implementimin më efikas të Programit të Përputhshmërisë (Programi), gjatë periudhës 1.1.2018 – 31.12.2018.

Ky raport vjetor i Përputhshmërisë që hartohet për herë të parë si pjesë e kompetencave ligjore të aktivitetit të Zyrtarit të Përputhshmërisë të shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. në lidhje me zbatimin e Programit të Përputhshmërisë, ka synuar të prezantojë mekanizmin për zbatimin e këtij Programi, përcaktimin e detyrave funksionale dhe detyrimeve të punonjësve të OST në lidhje me këtë Program, duke u mbështetur në monitorimin dhe raportimin e zbatimit të këtij Programi.

2. Kompania ALBGAZ sh.a.

ALBGAZ Sh.a. është një shoqëri aksionare me 100% të aksioneve të zotëruara nga shteti shqiptar, e krijuar me Vendimin Nr. 848, datë 7.12.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive “ALBPETROL” sh.a. dhe “ALBGAZ” sh.a., i ndryshuar. Selia qendrore e kompanisë ndodhet në qytetin e Tiranës. Gjithashtu kompania ka një zyrë përfaqësimi në qytetin e Fierit.

Shoqëria ALBGAZ Sh.a., do të funksionojë si një operator i kombinuar duke kryer veprimtarinë e operatorit të sistemit të transmetimit dhe operatorit të sistemit të shpërndarjes së gazit natyror në Republikën e Shqipërisë.

Me VKM Nr, 848, datë 07.12.2016 të ndryshuar me VKM Nr. 108, datë 23.2.2018, parashikohet detyrimi që aktivitetet e prodhimit dhe tregtimit të gazit natyror do të jenë të ndara nga aktivitetet e transportimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, por gjithashtu shprehet edhe detyrimi për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive që ushtrojnë veprimtari në fushën e gazit natyror, respektivisht për shoqërinë “ALBPETROL” Sh.a. do të jetë ministria përgjegjëse për energjinë (ish MIE) dhe për shoqërinë “ALBGAZ” Sh.a. do të jetë ministria përgjegjëse për infrastrukturën (MIE).

Rrjeti i tubacioneve është i shpërndarë në të gjithë pjesën perëndimore të Shqipërisë dhe përfundon në ORC në Ballsh. Infrastruktura vendase e rrjetit të gazit në Shqipëri ka një shtrirje më të madhe se infrastruktura e naftës. Fushat e gazit shtrihen nga Durrësi deri në Delvinë, duke krijuar kështu një mundësi për konsumatorët për t'u lidhur me rrjetin. Infrastruktura e kufizuar e gazit vendas në Shqipëri në disa pjesë të saj është jashtë gjendjes operative dhe nevojiten punime të mëdha rehabilitimi. ALBGAZ Sh.a. administron rreth 500 km tubacione magjistrale të transportit të gazit të ndertuar para më shumë se 40 vjetesh, me teknologji tashmë të vjetëruar, ku masat mbrojtëse nga korozioni janë minimale.

Aktualisht objekti kryesor i aktivitetit të Shoqërisë ALBGAZ Sh.a. si një operator i kombinuar, është të ofrojë transportimin dhe shpërndarjen e gazit natyror nëpërmjet rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes, dhe potencialisht mund të përfshijë në të ardhmen edhe aktivitetin e depozitimit nëntokësor të gazit natyror dhe të impiantit të gazit natyror të lëngëzuar.

Shoqëria realizon objektin e veprimtarisë së saj sipas Ligjit Nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar, më konkretisht:

- Kryerja e veprimtarive të nevojshme dhe të drejtpërdrejta të lidhura me operimin dhe funksionimin e rrjetit të transmetimit dhe rrjetit të shpërndarjes së gazit natyror, të në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Zhvillimin e rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes të gazit natyror sipas planeve financiare të aprovuara në përputhje me perspektivat e zhvillimit ekonomik, politikave kombëtare, rajonale dhe planeve kombëtare të aprovuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë apo Komunitetit të Energjisë, sikurse janë Strategjia Kombëtare e Energjisë për periudhën 2018 – 2030, miratuar me VKM Nr. 480, datë 31.7.2018, si dhe Master Plani i Gazit për Shqipërinë, miratuar me VKM Nr. 87, datë 14.2.2018.
- Propozimin, zhvillimin dhe adaptimin e kodit të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes të gazit natyror.
- Dhënies së aksesit pa diskriminim tek të gjithë operatorët e licencuar sipas legjislacionit në fuqi.
- Balancon rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes, së gazit natyror.
- Shërbime të tjera për klientët, që janë të nevojshme për të përmbushur detyrimet ndaj tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Nxjerrja e gazit si dhe menaxhimi i furnizimit të tij në Shqipëri është bërë nga Shoqëria me pronësi shtetërore siç është Albpetrol Sh.a. dhe nga kompanitë që ushtrojnë veprimtarinë e zhvillimit të prodhimit në vendburimet ekzistuese në kuadër të Marrëveshjeve Hidrokarbure të nënshkruara me

ALBPETROL sh.a. dhe të miratuara me Vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave në përputhje me dispozitat e ligjit Nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për Hidrokarburet (Kërkimi dhe Prodhimi)”, të ndryshuar. Numri i përgjithshëm i puseve të shpuar të gazit është mbi 500, por aktualisht numri i puseve prodhues të gazit është zvogëluar në rreth 20 puse. Aktualisht prodhimi i gazit natyror shërben kryesisht për plotësim të një pjese të nevojave teknologjike të industrisë së naftës. Gazi natyror historikisht ka qenë një element i rëndësishëm për furnizimin e tregut shqiptar me energji, por kontributi i tij i deritanishëm ka qenë i ulët, për shkak të niveleve minimale të prodhimit.

Shqipëria është i vetmi vend Evropian i cili nuk është i lidhur me rrjetet ndërkombëtare të gazit natyror. Mënyra më optimale për lidhjen e Shqipërisë me rrjetin ndërkombëtarë të gazit është ajo nëpërmjet magjistratit rajonal të gazit që është Projekti “TAP”, pjesë e Korridorit Jugor të Gazit, i cili do të kontribuojë në diversifikimin dhe sigurinë e furnizimit me gaz të Europës, por edhe në zhvillimin e gazifikimit të Shqipërisë dhe në krejt zhvillimin ekonomik të saj.

2.1. Forma ligjore dhe statusi i kompanisë OST

ALBGAZ Sh.a. është certifikuar sipas Vendimit të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) Nr. 179 datë 08.11.2017 “Mbi Certifikimin e Shoqërisë Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror ALBGAZ Sh.a.”, si OST dhe OSSH i gazit natyror.

Forma ligjore e OST është si një person juridik Shqiptar që ka formën ligjore të shoqërisë aksionare me ofertë private, sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar (“Ligji për Shoqëritë Tregtare”). Aksionari i vetëm i Shoqërisë është ministria përgjegjëse për infrastrukturën (aktualisht Ministria e Infstrukturës dhe Energjisë -MIE) për llogari të Republikës së Shqipërisë, me adresë në, Rruga “Abdi Toptani”, 1001, Tiranë, Shqipëri.

Struktura e aksionerëve të kompanisë OST, nuk përfshin marrëdhënien e aksionereve të OST me kompani të angazhuara me prodhimin dhe/ose furnizimin me gaz natyror dhe energji elektrike, ose ato që kanë ndonjë interes komercial.

Vendimmarrja dhe administrimi i Shoqërisë është strukturuar sipas sistemit me dy nivele, në përputhje me Pjesën V, Titulli IV, Kapitulli III i Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Organet drejtuese janë sipas rëndësisë; Asambleja e Përgjithshme e përbërë nga Ministri i linjës dhe është organi më i lartë Vendimmarrës i Shoqërisë. Këshilli Mbikëqyrës i përbërë nga gjashtë anëtarë të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme, është organi i shoqërisë i ngarkuar me mbikëqyrjen e veprimtarisë së Administratorit sipas politikave të Shoqërisë, neneve të Statutit të shoqërisë dhe të legjislacionit të zbatueshëm. Administratori i shoqërisë zgjidhet nga Këshilli Mbikëqyrës me shumicë të thjeshtë dhe autorizohet të ushtrojë të gjitha kompetencat ekzekutive të dhëna nga ligji dhe/ose nga Statuti i Shoqërisë.

2.2. Filialet e OST dhe/ose kompanive të tjera ku OST është aksionar

OST e gazit, ALBGAZ sh.a., ka zyrat kryesore në Tiranë me adresë “Njësia Administrative Nr. 5, rruga e “Kosovarëve”, pallati “Ndër Pro” Sh.p.k., dhe zyra në Fier.

ALBGAZ sh.a. është aksionare e 75% të shoqërisë së përbashkët (“joint venture”) me shoqërinë italiane SNAM Spa tek shoqëria. “Albanian Gas Service Company” Sh.a. (AGSC) që ka si objekt të saj kryesor mirëmbajtjen e sistemit të tubacionit të gazsjellësit TAP në territorin shqiptar.

Ngritja e shoqërisë “Albanian Gas Service Company” sh.a., si një shoqëri e përbashkët ndërmjet shoqërisë ALBGAS sh.a. dhe shoqërisë italiane SNAM S.p.A., është bërë me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës Nr. 12, datë 01.11.2018, nëpërmjet të cilit është miratuar edhe Akti i Themelimit dhe Statuti i saj. Shoqëria “Albanian Gas Service Company” sh.a., është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numër NUIS L82407006D, datë 7.12.2018, si dhe janë emëruar Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i kësaj shoqërie.

AGSC me zyra në adresën “Njësia Administrative Nr. 5, rruga e “Kosovarëve”, pallati “Ndër Pro” Sh.p.k., është krijuar si një shoqëri plotësisht operative e cila është përgjegjëse për kryerjen e veprimtarisë, mirëmbajtjes dhe shërbimeve teknike për gazsjellësin Trans Adriatic Pipeline AG, sipas marrëveshjes që do të lidhet midis kësaj shoqërie dhe shoqërisë dhe TAP AG.

OST ka në pronësi dhe:

- Truall 4.000m² dhe 188m² Ndërtesë në Drizë (Fier)
- Truall 4.290m² dhe 376m² Ndërtesë në Gjonçë (Fier)
- Truall 1.995m² dhe 56m² Ndërtesë në Lavdan (Mallakastër)
- Truall 1.366m² në Cërrik (Elbasan)
- Truall 980m² dhe 194m² Ndërtesë në Sheq i Madh (Fier)

2.3. Struktura e shoqërisë ALBGAS sh.a. (Operator i kombinuar i gazit natyror, OST dhe OSSH e gazit) përfshirë organet drejtuese.

Struktura e shoqërisë ALBGAS Sh.a. (Operator i kombinuar i gazit natyror, OST dhe OSSH e gazit) është miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës Nr. 211, datë 26/01/2017 “Mbi aprovimin e strukturës organizative dhe përshkrimeve të punës për Shoqërisë “ALBGAS Sh.a.”, si dhe është ndryshuar së fundmi me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës Nr. 16, datë 11.09.2018, “Mbi shtesën në strukturën organizative të Shoqërisë “ALBGAS Sh.a.”

Në shtojcën A, bashkëlidhur këtij raporti të përpushmërisë jepet skema e Strukturës organizative të shoqërisë ALBGAS Sh.a. (Operator i kombinuar i gazit natyror, OST dhe OSSH e gazit natyror), referuar Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës Nr. 16, datë 11.09.2018, “Mbi shtesën në strukturën organizative të Shoqërisë “ALBGAS Sh.a.”.

Në vazhdim jepen kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve drejtuese të shoqërisë “ALBGAS” Sh.a., referuar Statutit të shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme

Sipas Statutit të Shoqërisë ALBGAS sh.a. Asambleja e Përgjithshme merr Vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:

- a. Përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë, për zhvillimin e veprimtarisë tregtare të Shoqërisë;
- b. Miratimin e strategjisë dhe planeve financiare të Shoqërisë, si dhe të çdo ndryshimi të tyre;
- c. Ndryshimin e Statutit;
- d. Zgjedhjen, shkarkimin dhe pranimin e dorëheqjes të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe miratimin e skemës së shpërblimit të tyre;
- e. Zgjedhjen dhe shkarkimin e ekspertëve kontabël të rregjistruar dhe të likuiduesve.
- f. Miratimin e pasqyrave financiare, dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë, dhe ndryshimeve në politikat kontabële të Shoqërisë;
- g. Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë - 2018

- h. Pjesëtimin, tërheqjen, anulimin, riblerjen dhe rifitimn e aksioneve;
- i. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
- j. Përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedura të tjera kundër anëtarëve të organeve të Shoqërisë;
- k. Transformimi (duke përfshirë bashkimin, ngrirjen, ndarjen, ndryshimin e formës ligjore apo riorganizime të tjera të shoqërive), prishjen dhe likuidimin e Shoqërisë;
- l. Kërkimin nga Administratori apo Këshilli Mbikëqyrës për të dhënë informacion apo për të raportuar mbi çdo çështje lidhur me Shoqërinë; dhe
- m. Çështje e problematika të tjera të parashikuara nga Ligji për Shoqëritë Tregtare apo në Statutin e Shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme do të ketë të drejtë të japë miratimin e saj paraprak mbi çështjet dhe veprimet vijuese:

- a. Hapjen apo mbylljen e një shoqërie të kontrolluar apo shkrirjen e një interesi të Shoqërisë në një shoqëri të kontrolluar apo entitet tjetër, ose hyrjen në, ndryshimin apo përfundimin e çdo joint venture, partneriteti, konsorciumi, apo marrëveshjeje të ngjashme;
- b. Zvogëlimin, zgjerimin dhe çdo modifikim tjetër i objektit të aktivitetit ose qëllimit të Shoqërisë apo përfshirjen e Shoqërisë në çfarëdo aktivitetit pa lidhje me sa më lart;
- c. Veprime sipas nenit 13 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, marrje pjesë në, ndryshimin apo zgjidhjen e kontratave apo e çdo marrëveshjeje tjetër ndërmjet Shoqërisë, nga njëra anë, dhe Administratorit, anëtarit(ëve) të Këshillit Mbikëqyrës, apo çdo pale të tretë, e cila konsiderohet se është e lidhur me Administratorin e Shoqërisë apo anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës sipas neneve 13 (2) dhe (3) të Ligjit për Shoqëritë Tregtare nga ana tjetër;
- d. Lidhjen, ndryshimin apo zgjidhjen e një marrëveshjeje huaje apo kredie (të marra apo të dhëna), ose krijime të tjera (apo marrëveshjeje për krijim) të një borxhi të Shoqërisë që e tejkalon shumën prej 10.000.000 EURO për çdo veprim dhe 20.000.000 EURO kumulative për një vit;
- e. Heqjen dorë nga nga një e drejtë me një vlerë nominale që tejkalon 300.000 EURO për çdo veprim ose që tejkalon shumën totale 500.000 EURO në një vit të caktuar financiar;
- f. Të miratojë paraprakisht, shitjen dhe cdo lloj disponimi të aseteve të paluajtshme ku vlera e një kontrate e lidhur me një subjekt është mbi 300,000 EURO.
- g. Të miratojë paraprakisht shitjen apo cdo formë disponimi të aseteve të luajtshme nëse vlera e një kontratë është mbi 300,000 EURO ose nëse vlera kumulative e këtyre kontratave është mbi 700.000 EURO brenda një viti financiar.
- h. Çdo çështje dhe/ose veprim tjetër për të cilin Asambleja e Përgjithshme ka rezervuar, me Vendim të posaçëm, të drejtën e miratimit paraprak.

Procedurat e Asamblesë së Përgjithshme,

- a. Asambleja e Përgjithshme mund të përcaktojë rregulla për procedurat e mbajtjes dhe pjesëmarrjen në asamble. Këto rregulla miratohen nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e tre të katërtave të kapitalit, të përfaqësuar në mbledhje, sipas parashikimeve të ligjit.
- b. Asambleja e Përgjithshme cakton një kryetar për përgatitjen dhe drejtimin e mbledhjes, si edhe një sekretar.
- c. Të gjitha Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal.
- d. Procesverbali i çështjeve të shqyrtuara në mbledhjen e Asamblesë tregon: datën dhe vendin e mbledhjes, mënyrën e thirrjes, rendin e ditës, emrat e Kryetarit dhe Sekretarit të Asamblesë, numrin e aksioneve me të cilat është votuar dhe kuorumi i arritur, dokumentet dhe raportet e shqyrtuara në mbledhjen e Asamblesë, një përmbledhje të debateve, tekstin

e Vendimeve të kaluara për votim dhe rezultatin e votimit. Proces – verbali firmoset nga Kryetari dhe Sekretari i Asamblesë. Administratori i shoqërisë është përgjegjës për ruajtjen e Vendimeve dhe proces-verbaleve të mbledhjes.

- e. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mund të zhvillohen edhe nëpërmjet telekonferencës apo videokonferencës, ose me mjete të ngjashme elektronike, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të jenë të identifikuar dhe t'u jepet mundësia të ndjekin diskutimin e të marrin pjesë aktivisht në të, në përputhje me kërkesat e ligjit të zbatueshëm; në këtë rast Asambleja e Përgjithshme do të konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhen si Kryetari ashtu edhe Sekretari i mbledhjes.
- f. Vendi i zgjedhur (apo mënyra e zhvillimit, nëse është e zbatueshme), data dhe koha e organizimit të kësaj mbledhjeje, si edhe programi i mbledhjes në fjalë do t'u njoftohen aksionarëve dorazi, nëpërmjet postës, postës elektronike, apo faksit jo më vonë se 21 (njëzet e një) ditë përpara datës së caktuar të mbledhjes. Nëse mbledhja zhvillohet nëpërmjet komunikimeve elektronike ajo do të konsiderohet si e mbajtur në kohën dhe selinë e Shoqërisë. Procedura e njoftimit të aksionereve dhe procedurat e takimit të Asamblesë do të jenë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi për shoqëritë aksionare.

Këshilli Mbikëqyrës

Sipas Statutit të Shoqërisë ALBGAZ sh.a. Këshilli Mbikëqyrës ka për detyrë të:

- a. Të japë direktiva për Administratorin për zbatimin e politikave të shoqërisë.
- b. Vëzhgojë dhe mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të Shoqërisë nga Administratori; dhe
- c. Përgatisë, me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme masa të cilat janë në kompetencën e kësaj të fundit; të rekomandojë Vendime për t'u marrë nga Asambleja e Përgjithshme, dhe të ekzekutojë Vendimet e saj.

Këshilli Mbikëqyrës është kompetent të:

- a. Thërrasë Asamblenë e Përgjithshme sa herë kjo konsiderohet e nevojshme për interesat e Shoqërisë dhe menjëherë pas verifikimit të rrethanave të parashikuara nga pikat 3, 4 dhe 5 të nenit 136 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare;
- b. Sigurojë që Shoqëria zbaton ligjet dhe standardet e zbatueshme të kontabilitetit;
- c. Shqyrtojë librat e Shoqërisë, dokumentet dhe asetet;
- d. Sigurojë që pasqyrat vjetore të kontabilitetit dhe raporti i performancës së Shoqërisë të përgatiten në mënyrë të rregullt nga Administratori, dhe që ky i fundit të përmbushë çdo detyrim tjetër ligjor apo statutor për raportim apo publikim. Këto dokumente duhen miratuar e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, për t'i paraqitur në Asamblenë e Përgjithshme së bashku me një raport të Këshillit Mbikëqyrës në lidhje me arsyet e miratimit dhe një përshkrim të mënyrave se si është monitoruar administrimi gjatë vitit financiar; dhe
- e. Sigurojë që investigimi i librave dhe i regjistrave të kryhet të paktën çdo vit nga një ekspert kontabël i pavarur dhe që raporti i auditorit drejtuar Asamblesë së Përgjithshme t'i jetë vënë në dispozicion çdo anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës. Raporti i Këshillit sipas gërmës së mëparshme duhet të përmbajë gjithashtu mendimin e Këshillit mbi raportin e investigimit.
- f. Të krijojë komitete të përhershme apo të posaçme, për çështje të ndryshme operationale të shoqërisë;
- g. Të krijojë komitetin e posacëm të investigimit të brendshëm, në të cilin bëjnë pjesë jo më pak se 3 anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës;

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë - 2018

- h. Të kërkojë informacion dhe të iniciojë procese llogaridhënie për cdo rast që e sheh të arsyeshme lidhur me Vendimet e marra nga Administratori, ose aktivitetin e shoqërisë apo divizioneve e departamenteve të tjera të saj.
- i. Të miratojë strukturën organizative dhe strukturën e personelit të Shoqërisë, si dhe ndryshimin e tyre;
- j. Të emërojë dhe të lirojë nga detyra Administratorin e Shoqërisë.
- k. Të miratojë strukturën e drejtorisë së auditit të brendshëm, të shoqërisë dhe të emërojë drejtorin e anëtarët e saj.
- l. Të miratojë planin vjetor të investimeve, përfshirë marrëveshjet në lidhje me kapacitetet e interkonjeksionit ndërkufitar, shërbimet e transmetimit, depozitimit dhe të impianteve apo të shpërndarjes së gazit natyror.
- m. Të miratojë hyrjen në një marrëveshjeje huaje apo kredie (të marra apo të dhëna), ose krijime të tjera (apo marrëveshje për krijim) të një borxhi të Shoqërisë deri në shumën prej 10.000.000 EURO;
- n. Të japë miratimin paraprak për blerjen e aseteve të paluajtshme mbi vlerën 100.000 Euro.
- o. Të miratojë paraprakisht shitjen apo cdo formë disponimi të aseteve të paluajtshme të Shoqërisë me vlerë nga 50.000 deri 100.000 EURO, dhe të kërkojë paraprakisht miratimin e Asamblesë për vlera më të mëdha se 100.000 EURO.
- p. Të miratojë paraprakisht shitjen e aseteve të luajtshme në rast se vlera e një kontrate është nga 50.000 deri 100.000 EURO, ose nëse vlera kumulative e këtyre kontratave është nga 250.000 deri 500.000 EURO brenda një viti financiar.
- q. Të miratojë paraprakisht ndryshimet në planin financiar të Shoqërisë me kërkes nga Administratori dhe të marrë aprovimin nga Asambleja për ndryshimet që janë me të larta se 25% (njëzet e pesë përqind) e vlerës fillestare të planit financiar të vitit ushtrimor.
- r. Të miratojë paraprakisht ndryshimet në planin financiar të Shoqërisë me kërkes nga Administratori kur ka ndryshim të vlerës fillestare më pak se 25% (njëzet e pesë përqind).
- s. Të miratojë paraprakisht propozimet e Administratorit për donacione, sponsorizime, financimin e projekteve sociale, kulturore dhe bamirësie.
- t. Përveç rasteve specifike të përcaktuara në gërmën I, m,n,o,p të pikës 3 neni 16, të miratojë ndryshimet nga plani i miratuar për furnizimin me mallra, shërbime apo shpenzime të tjera. Është kompetencë e Këshillit Mbikqyrës t'i propozojë Asamblesë së Përgjithshme ndryshimin e këtyre limiteve një herë në vit gjatë miratimit të buxhetit për vitin pasardhës, si edhe sa herë që kjo mund të përbëjë stimul për rritjen e aktivitetit financiar dhe ekonomik të shoqërisë.

Përbërja e Këshillit Mbikqyrës

- a. Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga 6 (gjashtë) anëtarë, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme.
- b. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës e mbajnë postin e tyre për një periudhë prej tre vjetësh, në përfundim të së cilës ata mund të ri-emërohen.
- c. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës janë individë, të cilët duhet të jenë të pavarur dhe të ndryshëm nga administratorët e shoqërisë, administratorët e shoqërive të tjera të të njëjtit grup, si dhe personat e lidhur me personat e mësipërm. Anëtarë të pavarur të Këshillit Mbikqyrës vlerësohen personat, të cilët nuk kanë konflikt interesash apo anëtarësie, sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 13 dhe të pikës 3 të nenit 167 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Çdo emërim, i bërë në kundërshtim me këto parashikime, është absolutisht i pavlefshëm. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës detyrohen të informojnë menjëherë shoqërinë për çdo konflikt interesi, e anëtarësie në këshillat e shoqërive të tjera.
- d. Çdo vend i mbetur vakant në Këshillin Mbikqyrës si pasojë e dorëheqjes, shkarkimit, paaftësisë apo vdekjes, do të plotësohet nga një anëtar i ri i emëruar me Vendim të

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë - 2018

Asamblesë së Përgjithshme. Anëtari i ri do të mbetet në detyrë deri në përfundimin e mandatit të anëtarit të zëvendësuar.

- e. Këshilli Mbikëqyrës zgjedh Kryetarin ndërmjet anëtarëve të tij si dhe sekretarin e Këshillit Mbikëqyrës.
- f. Përveç sa përcaktohet në këtë Nen, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës duhet të plotësojnë kushtet, detyrimet, përgjegjësitë dhe kriteret e parashikuara në nenet 163 nga (1) në (3) dhe 167 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Procesi Vendimmarrës i Këshillit Mbikëqyrës

- a. Këshilli Mbikëqyrës mund të zhvillojë mbledhjet e tij në Republikën e Shqipërisë, në një vend të caktuar nga Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës. Nëse nuk caktohet asnjë vend tjetër, Këshilli Mbikëqyrës do të zhvillojë mbledhjet e tij në selinë zyrtare të Shoqërisë.
- b. Këshilli Mbikëqyrës do të mbledhet të paktën gjashtë herë në vit. Çdo mbledhje tjetër e Këshillit Mbikëqyrës zhvillohet me kërkesë të Kryetarit, një anëtar i Këshillit Mbikëqyrës ose të Administratorit.
- c. Mbledhja mund të thirret nga Kryetari, me iniciativën e tij/saj ose me kërkesë të një anëtar tjetër të Këshillit Mbikëqyrës apo të Administratorit. Si rregull thirrja duhet të bëhet 3 (tre) ditë përpara me leter, faks ose cdo komunikim elektronik të besueshëm, por thirrja mund të jetë e vlefshme edhe verbalisht dhe pa afat, nëqoftë se anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës e pranojnë atë. Çdo thirrje duhet të tregojë çështjet kryesore të rendit të ditës.
- d. Procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës mbahen në formë dhe në përmbajtjen e përcaktuar në nenin 161 (3) të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- e. Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës janë të vlefshme në rast se më shumë se 1/2 e anëtarëve të tij janë të pranishëm personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve. Nëse ky kuorum nuk arrihet, mbledhja shtyhet për një datë tjetër. Këshilli Mbikëqyrës vendos me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm. Në rast barazimi votash, vota e Kryetarit do të jetë Vendimtare. Si përjashtim nga ky rregull, Këshilli Mbikëqyrës vendos me unanimitet mbi rregulloren e brendshme të Këshillit.
- f. Një anëtar i Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës në rastet e parashikuara nga neni 162 (3) i Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- g. Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës mund gjithashtu të drejtohen nëpërmjet telekonferencës apo videokonferencës, ose nëpërmjet mënyrave të tjera elektronike të ngjashme, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të identifikohen rregullisht dhe të mund të ndjekin diskutimin dhe të mund të marrin pjesë në mënyrë aktive në të.
- h. Këshilli Mbikëqyrës mund gjithashtu të marrë Vendimet e tij jashtë mbledhjes nëpërmjet komunikimit me shkrim (dorëzuar personalisht, me postë, postë elektronike ose votimit me faks). Në këtë rast, personi që thërret Këshillin Mbikëqyrës i dorëzon (personalisht, postë, postë elektronike ose faksimile) anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës kopje identike të Vendimit të propozuar, ku përmbahen udhëzime të qarta se si anëtarët do të hedhin votën e tyre dhe kthejnë Vendimin e nënshkruar. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës shprehin votën e tyre, në përputhje me udhëzimet e projekt Vendimit, nënshkruajnë rregullisht kopjen përkatëse dhe e rikthejnë siç udhëzohet në udhëzimet. Një anëtar i Këshillit Mbikëqyrës vendos në lidhje me Vendimin e propozuar dhe ia rikthen Shoqërisë brenda 7 (shtatë) ditëve nga data kur Vendimi i propozuar i është dorëzuar këtij anëtar, ose përndryshe do të konsiderohet sikur ka marrë pjesë në procedurën e Vendimmarrjes dhe ka abstenuar nga votimi në lidhje me Vendimin.
- i. Këshilli Mbikëqyrës mund të kërkojë pjesëmarrjen e Administratorit në mbledhjet e tij dhe të kërkojë nga Administratori të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të kryer detyrat dhe përmbushur detyrimet e tij.

Administratori

Sipas Statutit të Shoqërisë ALBGAZ sh.a. Administrimi i Shoqërisë:

- a. Shoqëria administrohet nga një Administrator i cili autorizohet të ushtrojë të gjitha kompetencat ekzekutive të dhëna nga ligji dhe/ose nga ky Statut.
- b. Administratori zgjidhet nga Këshilli Mbikqyrës me shumicë të thjesht.
- c. Administratori duhet të ketë kombësi Shqipëtare, dhe zgjidhet për një periudhë prej tre vjetësh me të drejtë rizgjedhjeje.
- d. Në rast se pozicioni i Administratorit mbetet vakant si pasojë e dorëheqjes, shkarkimit, paaftësisë apo vdekjes, atëherë Këshilli Mbikqyrës do të zgjedhë minimalisht brenda 3 ditëve Administratorin e ri..
- e. Me pranimin e zgjedhjes së tij, Administratori pranon se marrëdhënia e tij me Shoqërinë janë marrëdhënie kontraktuale sipas legjislacionit në fuqi.
- f. Administratori kryen dhe detyra të tjera të cilat mund t'i jepen herë pas here nga Asambleja e Përgjithshme ose nga Këshilli Mbikqyrës, në përputhje me këtë Statut dhe me ligjin.
- g. Administratori duhet të zbatojë kriteret, parimet, parashikimet, kufizimet, përjashtimet dhe përgjegjësitë e parashikuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe në veçanti me parashikimet e nenit 167 të këtij ligji.

Kompetencat e Administratorit

- a. Administratorit është i ngarkuar me administrimin dhe përfaqësimin e Shoqërisë.
- b. Administratori do të vendosë për çdo çështje që nuk është kompetencë ekskluzive e Asamblesë e Përgjithshme ose e Këshillit Mbikqyrës.
Në veçanti, Administratori ka kompetencën dhe detyrën që të:
 - c. Administrojë Shoqërinë duke zbatuar politikën e saj;
 - d. Të përfaqësojë Shoqërinë në raport me palët e treta;
 - e. Vendosë bashkëpunime jetëgjata biznesi, dhe të propozojë politika në lidhje me formimin e shoqërive ose grupeve të reja;
 - f. Sigurojë mbajtjen dhe administrimin e duhur të librave dhe dokumenteve të kontabilitetit;
 - g. Të kujdeset për përgatitjen, e të nënshkruajë pasqyrat financiare vjetore dhe bilancin dhe raportin e performancës, e t'ia paraqesë ato për miratim Këshillit Mbikqyrës e më pas Asamblesë së Përgjithshme, së bashku me propozimin për shpërndarje të fitimeve apo mbulime të humbjeve;
 - h. Krijojë një sistem monitorimi të hershëm për zhvillime që kërcënojnë ekzistencën e Shoqërisë;
 - i. Raportoje pranë Këshillit Mbikqyrës në lidhje me zbatimin e politikave të biznesit dhe për realizimin e transaksioneve me rëndësi të veçantë për performancën e Shoqërisë;
 - j. Kryejë çdo regjistrim ose publikim të të dhënave të Shoqërisë që kërkohet nga Ligji për Shoqëritë Tregtare, apo ligje të tjera në fuqi;
 - k. Kryejë detyra të tjera të parashikuara nga ligji ose nga ky Statut; dhe
 - l. Njoftojë menjëherë Kryetarin e Këshillit Mbikqyrës dhe Asamblesën e Përgjithshme në rastet e parashikuara nga pikat 3, 4 dhe 5 të nenit 136 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare si:
 - Bilancet vjetore ose të përkohshme të Shoqërisë tregojnë ose paraqesin qartësisht mundësinë se humbjet arrijnë deri në 50% të kapitalit të regjistruar, apo se asetet e Shoqërisë nuk do të mbulojnë detyrimet e saj që do të bëhen të kërkueshme brenda 3 muajve të ardhshëm. Në lidhje me këtë çështje, Asamblesë së Përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i pavarur;
 - ka një propozim për të shitur apo disponuar ndryshe asetet e cilat përfaqësojnë më shumë se 5% të aseteve të Shoqërisë ose me vlerë më shumë se 200.000 euro të aseteve të paluajtshme dhe 200.000 euro të aseteve të luajtshme. Asamblesë së

Përgjithshme i paraqitet një raport i një eksperti kontabël të pavarur, përveç kur transaksioni i mësipërm kryhet në tregun e bursës ose si pjesë e veprimtarisë së përditshme të Shoqërisë, të kryera në kushte normale të tregut.

- m. Administratori është i detyruar të marrë miratim paraprak nga Asambleja e Përgjithshme dhe ose Këshilli Mbikqyrës përpara marrjes dhe/ose zbatimit të ndonjë Vendimi në lidhje me çështjet specifike të parashikuara në nenin 13.3 dhe nenin 16.3 të këtij Statuti
- n. Detyrat, që ligji i cakton Këshillit Mbikqyrës, nuk mund t'i delegohen Administratorit
- o. Administratori ka të drejtë që Brenda kompetencave të tija t'u japë një ose disapunonjësve të shoqërisë, të drejtën për të kryer veprime të veçanta apo kategori veprimesh, me të drejtën e nëndelegimit
- p. Aktet me të cilat Shoqëria merr përsipër detyrimet ndaj të tretëve, duhet të nënshkruhen nga Administratori, ose personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit përkëto akte.

3. Programi i Përputhshmërisë – Metodologjia e kontrollit

Shoqëria ALBGAS sh.a. si një operator i kombinuar i gazit duke kryer veprimtarinë e operatorit të sistemit të transmetimit dhe operatorit të sistemit të shpërndarjes së gazit natyror në Republikën e Shqipërisë, krijon dhe implementon një Program të Përputhshmërisë, në mbështetje të Ligjit 102/2015, datë 23.09.2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar, referuar Neni 47 të tij, në të cilin përcaktohen masat e nevojshme për garantimin e sjelljes jodiskriminuese si dhe metoda për monitorimin e përputhshmërisë me këtë program, i cili miratohet nga ERE. Programi i Përputhshmërisë përcakton detyrimet e veçanta për të punësuarit e OST-së, me qëllim plotësimin e këtyre objektivave. Përputhshmëria me programin monitorohet në mënyrë të pavarur nga një Zyrtar i Përputhshmërisë.

Ky Program Përputhshmërie (këtu dhe më poshtë Programi) i shoqërisë ALBGAS sh.a., operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror (këtu dhe më poshtë OST) vendos kushtet për ndarjen dhe pavarësinë e OST sipas Ligjit Nr. 102/2015, datë 23.09.2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar, dhe ka për qëllim të përcaktojë masat që duhet ndërmarrë për të siguruar pavarësinë e kompanisë, të parandaloj çdo formë trajtimi apo sjellje diskriminuese në aktivitetet e OST, si dhe të përcaktojë detyrimet dhe procedurat e duhura për të monitoruar përputhshmërinë e punonjësve të OST për të përmbushur objektivat e përcaktuara në këtë Program.

Ky Program ka si qëllim të sigurojë:

- Ndarjen e duhur dhe pavarësinë e OST;
- Të shmangë sjelljet diskriminuese të OST ndaj pjesëmarrësve të tjerë të tregut të gazit natyror (këtu dhe më poshtë pjesëmarrësit) dhe përdoruesve të rrjetit;
- Parandalimin e aksesit tek kushtet koncesionare në sistemin e transmetimit të cilat duhet të ofrohen për pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit;
- Prezantimi i një mekanizmi për zbatimin e këtij Programi dhe përcaktimi i detyrave funksionale dhe detyrimeve të punonjësve të OST në lidhje me këtë; dhe
- Prezantimi i një mekanizmi për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të këtij Programi.

Metodologjia e kontrollit të Programit nga Zyrtari i Përputhshmërisë i ALBGAS sh.a. do jetë e tillë:

- Mbledhja e informacionit në forma shkresore, e-maile duke patur akses tek të dhënat e nevojshme dhe në zyrat e OST
- Verifikimi i dokumentacionit, i ankesave, i kontratave në mënyrë rastësore.

- Marrja pjesë në të gjitha mbledhjet e drejtuesve të OST dhe organeve korporative, përfshirë Asambleenë e Përgjithshme, Këshillin Mbikqyrës dhe njësitë drejtuese.

Takimi dhe intervista me punonjësit përgjegjës dhe stafin drejtues dhe investigim për detyrat, projektet dhe informacionin e mbledhur. Kryesisht identifikohen temat dhe diskutohen temat për devijimet nga Programi të cilat duhen të shpjegohen më tej.

Si rrjedhojë, për të siguruar zbatimin dhe monitorimin e këtij Programi dhe përmbushjen e detyrave, Zyrtari i Përputhshmërisë kryen investigimin e rregullt vjetor duke filluar nga periudha Janar 2018 dhe mbaruar Shkurt 2019, në përputhje me parimet e standardeve ndërkombëtare të investigimit, me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë të OST në menyrë sistematike, të pavaruar, dhe procedura vëzhguese për të evidentuar devijimet nga Programi. Përveç kësaj, vihet në dukje se investigimet e lartpërmendura janë bërë duke marrë në konsideratë parimet standarde (Standardi Ndërkombëtar ISO 19011) dhe praktikat më të mira, si më poshtë:

- Sjellja etike: Themeli i profesionalizmit (Besimi, integriteti, konfidencialiteti dhe diskrecioni)
- Prezantim i drejtë: Obligimi për të raportuar me vërtetësi dhe saktësi (Gjetjet e inspektimit, konkluzionet e inspektimit dhe raportet e inspektimit pasqyrojnë me sinqeritet dhe saktësi aktivitetet e inspektimit)
- Përkujdesja e duhur profesionale: Zbatimi i kujdesit dhe gjykimit në inspektim (Inspektorët ushtrojnë kujdes në përputhje me rëndësinë e detyrës që kryejnë dhe besimin e vendosur në to)
- Pavarësia: Baza për paanshmërinë e inspektimeve dhe objektivitetin e konkluzioneve të tij
- Qasja e bazuar në dëshmi: Metoda racionale për arritjen e konkluzioneve të besueshme dhe të riprodhueshme në një proces sistematik të investigimit

Inspektimi/investigimi u kryen në zyrat e ALBGAS sh.a. dhe të personave përgjegjës dhe përfshinin fazat e mëposhtme:

- Takimi parë
- Inspektimi/Investigimi në vend;
- Intervista / pyetësori
- Kontroll i dokumentacionit
- Takimi mbyllës

Inspektimi/investigimi është bazuar në katër parimet themelore të operimit sipas Vendimit të Bordit të ERE Nr. 77, datë 25.06.2017 “Mbi Miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror” sipas katër parimeve të mëposhtme:

I. Ndarja dhe pavarësia e OST

OST është e ndarë nga aktivitete e tjera që nuk kanë lidhje me transmetimin e gazit natyror. Drejtuesit e OST, janë të pavarur nga kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë e saj.

OST funksionon si operator i sistemit të transmetimit për gazin natyror sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në Ligjin Nr. 102/2015, datë 23.09.2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar, si dhe akteve të tjera ligjore dhe parashikimeve në Kodin e Rrjetit të Transmetimit, në proces përgatitje dhe miratimi.

II. Përfundimi i sjelljes diskriminuese

Në operimin e OST përcaktohet se duhet të sigurojë akses të barabartë në sistemin e transmetimit për të gjithë pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit të cilët përputhen me kërkesat e vendosura tek Ligji Nr. 102/2015, datë 23.09.2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar, akteve të tjera ligjore në fuqi dhe Kodit të Rrjetit të Transmetimit, në proces përgatitje dhe miratimi. Aktivitetet e OST përcaktohet se nuk duhet të kufizojnë ose ndikojnë në konkurrencën e drejtë në tregun e gazit natyror. Në rastin e një konflikti ekzistues të interesit ose konflikti të mundshëm, drejtuesi ose punonjësi i OST duhet të informojë në kohë Administratorin dhe Zyrtarin e Përputhshmërisë të kompanisë OST, por jo më vonë se dita tjetër e punës, pasi ai/ajo është vënë në dijeni për konfliktin ekzistues të interesit ose ndonjë rrethanë që mund të shkaktojë një konflikt interesi.

III. Politika e informacionit të kompanisë OST

Shoqëria ALBGAZ sh.a. në rolin e OST përcaktohet që duhet të sigurojë informacionin funksional dhe informacionin përkatës të sistemit të transmetimit dhe shërbimeve të saj, e cila nuk mbrohet si informacion i ndjeshëm tregëtar sipas kushteve dhe termave të akteve ligjore në fuqi dhe këtij Programi.

OST përcaktohet që duhet të sigurojë konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregëtar të marrë nga OST gjatë aktiviteteve funksionale dhe/ose komerciale, dhe duhet të marrë të gjitha masat e arsyeshme dhe të matura për të shmangur informacionin e ndjeshëm tregëtar në lidhje me aktivitetet të cilat përmbajnë vlera tregëtare për persona të tjerë nga shpërndarja diskriminuese. Informacion publik nënkupton çdo informacion që përgjithësisht njihet se ka një karakter publik, ose çdo informacion tek i cili aplikohen kërkesat për shpërndarjen e detyrueshme sipas legjislacionit në fuqi.

IV. Zbatimi i programit

Dispozitat e këtij Programi të Përputhshmërisë së ALBGAZ sh.a. kanë qenë të detyrueshme për të gjithë drejtuesit dhe punonjësit dhe në rastet referuar këtij Programi dhe kontratave të mbyllura nga OST ose tek aktet ligjore në fuqi, zbatimi i dispozitave të caktuara të këtij Programi është detyrues për përfaqësuesit e autorizuar të OST, për audituesit, këshilltarët, kontraktuesit, pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit si dhe palët e tjera të treta.

Monitorimi i vazhdueshëm për zbatimin siç duhet të Programit kryhet nga Zyrtari i Përputhshmërisë i cili funksionon në bazë dhe sipas kompetencave të ofruara sipas Ligjit Nr. 102/2015, datë 23.09.2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar, dhe kontratës së lidhur midis ALBGAZ sh.a. (OST) dhe Zyrtarit të Përputhshmërisë.

Sipas përcaktimeve Ligjit Nr. 102/2015, datë 23.09.2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar, si dhe kontratës së lidhur midis OST dhe Zyrtarit të Përputhshmërisë, çdo vit, jo më vonë se data 31 Mars, Zyrtari i Përputhshmërisë ka përgatitur për të dorëzuar në ERE një raport për përputhshmërinë e OST me këtë Program, i cili do të publikohet (në dy gjuhë) në faqen e internetit të ALBGAZ sh.a. (OST) dhe të ERE.

4. Katër parimet themelore që qeverisin aktivitetin e ALBGAZ sh.a.

ALBGAZ sh.a. si OST si e një vendi anëtar i Sekretariatit të Energjisë me qëndër në Vjenë, luan një rol Vendimtar në tregun e gazit natyror në vënd, duke siguruar funksionimin e një tregu të integruar të gazit natyror sipas kërkesave të legjislacionit kombëtar dhe direktivave të BE-së.

Më poshtë, analizohet progami i bazuar në katër parimet bazë të operimit, shqyrton se si aktiviteti i ALBGAS sh.a. si OST duhet të qeveriset sipas standarteve që përcakton legjislacioni në fuqi.

4.1. Ndarja dhe pavarësia e OST

Shoqëria ALBGAS sh.a. si OST është krijuar të ofroj transmetim të gazit natyror nëpërmjet rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror në Shqipëri. Si OST dhe OSSH (operator i kombinuar) i gazit natyror, ALBGAS sh.a. ka rol deciziv në tregun e gazit vëndas, duke siguruar funksionimin e tregut të brendshëm të gazit në Shqipëri, bazuar në kërkesat rregullatore vëndase dhe evropiane. Si një parakusht thelbësor, OST duhet të jetë plotësisht i pavarur nga kompani vertikalisht të integruara ose bashkëpunëtorët e tij dhe të kryejë detyrat e tij me paañesi dhe transparencë, duke zbatuar rregulla strikte për të siguruar konkurrencë të lirë.

Këto parakushte janë vlerësuar si kërkesa të rëndësishme rregullatore për OST dhe arritja e tyre ka qenë një shqetësim kryesor për kompaninë. Këto dhe kërkesa të tjera të rëndësishme rregullatore, të cilat duhet të jenë një prioritet themelor për OST. Për të arritur përputhshmërinë me kërkesat e mësipërme, ka qenë e domosdoshme që secila prej njësive organizative të OST të jenë në përputhje me katër parimet bazë të operimit, sipas Programit të Përputhshmërisë.

4.1.1. Ndarja e OST

ALBGAS sh.a. si OST është certifikuar sipas Vendimit Nr. 179 datë 08.11.2017 “Mbi Certifikimin e Shoqërisë Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror ALBGAS SH.A.”, si OST dhe OSSH i gazit natyror.

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve 10 dhe 11 të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, ALBGAS sh.a. si OST i plotëson kushtet dhe nuk është e përfshirë në aktivitetet që kanë të bëjnë me prodhimin dhe/ose furnizimin me gaz natyror, pavarësisht se këto aktivitete janë pothuaj në vlera krejtësisht minimale dhe konsiderohen si inegzistente.
- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve 12 dhe 13 dhe nënpikat e tyre të Programit, ALBGAS sh.a. si OST sipas Vendimit Nr. 179 datë 8.11.2017 “Mbi Certifikimin e Shoqërisë Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror “ALBGAS SH.A.” është në diskutime me ERE dhe Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë (nën vëmëndjen e Zyrtarit të Përputhshmërisë). Në vijim sa më sipër, duke qenë se ALBGAS sh.a. si OST faktikisht nuk ka të bëjë me veprimtarinë e të licencuarve që kanë aktivitete prodhimin dhe/ose furnizimin me gaz natyror, aktivitete këto të cilat janë pothuaj në vlera krejtësisht minimale dhe konsiderohen si inegzistente, OST në këto kushte konsiderohet se përkohësisht ka plotësuar kushtet e vendosura në Vendimin ERE Nr. 179, datë 8.11.2017, gjë për të cilën edhe me shkresën e protokolluar në ERE Nr. 233/7 prot. datë 16.10.2018, është kërkuar shtyrje te afatit të plotësimit të plotë të kushteve të parashikuara në Vendimin Nr. 179, datë 8.11.2017 deri në datë 10.4.2019.

OST argumenton se shkak për shtyrjen e plotësimit në kohë të kushteve të sipërpërmëndura janë situatat krejt specifike të mosfunksionimit real të tregut të gazit në Shqipëri, fakt i konfirmuar edhe nga institucionet e tjera përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e sektorit të gazit.

4.1.2. Pavarësia drejtuese e OST

Drejtuesit e ALBGAZ sh.a. si OST, të tillë si Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës, Administratori (menaxheri i përgjithshëm), kryetarët dhe personeli udhëheqës (drejtuesit e njërive strukturore), duhet të jenë të pavarur nga kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë e saj.

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve 15 të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, dhe nënpiikat e saja, ALBGAZ sh.a. si OST i plotëson kërkesat e Programit duke marrë masa që është arritur pavarësia e drejtuesve.

4.1.3. Pavarësia funksionale dhe Vendimarrëse e OST

Pavarësia funksionale dhe Vendimarrëse e ALBGAZ sh.a. si OST ka të bëjë, nga njëra anë me zhvillimin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, si departament kryesor për të udhëzuar punonjësit dhe rendin e punës për të kryer detyrat siç duhen, dhe nga ana tjetër, pavarësia dhe/ose ndarja e OST për Vendimarrje të pavarur.

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve 16, 17, 20, 21 të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, ALBGAZ sh.a. si OST ka pavarësi totale funksionale dhe Vendimarrëse.
- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafit 18 të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, ALBGAZ sh.a. si OST, gjatë periudhës 2017- 2018 ka qenë angazhuar për të realizuar objektivat e mëposhtme:

Së pari: Aktiviteti në periudhën 2018 për transportimin dhe shpërndarjen e sasive tepër minimale të gazit natyror nëpërmjet infrastrukturës ekzistuese te gazit:

- Do të ndjekë aktivitetin e transportimit dhe shpërndarjes së sasive tepër minimale të gazit natyror, përfshirë edhe kontratat me konsumatorët për shpërndarjen e gazit (ndërkohë që furnizuesi dhe konsumatori do të jetë vetë Albpetrol Sh.a.).
- Do të ketë në ndjekje nëpërmjet drejtorisë përkatëse të shoqërisë, edhe gjithë asetet e infrastrukturës ekzistuese të gazit që i kanë kaluar shoqërisë “ALBGAZ” Sh.a., duke ndërmarrë veprimet dhe investimet e nevojshme për evidentimin por edhe mirëmbajtjen dhe më tej, nëse është e argumentuar edhe rehabilitimin e pjesëve të veçanta të kësaj infrastrukture.
- Do të sigurojë bashkëpunim me shoqërinë Albpetrol Sh.a. si dhe me shoqëritë e tjera hidrokarbure që janë duke operuar në kuadër të Marrëveshjeve Hidrokarbure, sikurse janë kompanitë “Bankers Petroleum Albania “ Ltd, SHELL Albania, etj.

Së dyti: Aktiviteti për periudhën 2018 në projekte të transportimit dhe shpërndarjes së gazit natyror që kanë të bëjnë me zhvillimin e sektorit të gazit në Shqipëri, sipas Master Planit të Gazit Natyror për Shqipërinë, përfshirë edhe interkoneksionin rajonal:

- Në aktivitetin teknik të shoqërisë “ALBGAZ” Sh.a. (lidhur me pjesëmarrjen e shoqërisë direkt ose në emër të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë) do të jetë pjesëmarrja në projekte të transportimit dhe shpërndarjes së gazit natyror që kanë të bëjnë me zhvillimin e sektorit të gazit në Shqipëri, apo në projekte interkoneksioni rajonal dhe European, përfshirë edhe angazhimin e shoqërisë në marrëveshje bilaterale ose multilaterale vetëm

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë - 2018

ose në bashkërendim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, sikurse është edhe Traktati për krijimin e Komunitetit të Energjisë.

- Angazhimi në bashkëpunim direkt ose indirekt (edhe me subjektet përkatëse të Malit të Zi) në realizimin e projektit të Gazsjellësit Ionian Adriatik (Ionian Adriatic Pipeline – IAP).
- Angazhimi në bashkëpunim direkt ose indirekt (edhe me subjektet përkatëse të Kosovës) në realizimin e projektit të Gazsjellësit Shqipëri – Kosovë (ALKOGAP), ku gjatë vitit 2018 u punua për të përgatitur studimin e parafizibilitetit për këtë projekt. (Ishte miratuar një financim prej 0,3 milionë Euro nga WBIF).
- Angazhimi në bashkëpunim direkt ose indirekt (edhe me shoqërinë TAP AG, si dhe në kuadër të projektit me SECO) në realizimin e projektit të Gazsjellësit që do të lidhë projektin TAP me TEC-in Vlorë, duke përfshirë edhe periudhën gjatë fazës së përgatitjes së Studimit të Fizibilitetit. (Ishte miratuar një financim prej 0,3 milionë Euro nga projekti i Qeverisë Zviceriane (SECO) për ngritjen e kapaciteteve në sektorin e gazit natyror). Në kuadër të Raundit të 20-të të EBIF, në Dhjetor 2018 është miratuar një financim prej 1,1 milionë Euroe për përgatitjen e projektit të plotë teknik të këtij gazsjellësi.

Së treti: Shoqëria “ALBGAZ” Sh.a. do të angazhohet për të siguruar një bashkëpunim institucional dhe ligjor në aspektin e zhvillimit strategjik edhe me shoqëri dhe institucione të huaja të fushës së gazit.

Së katërti: Një objektiv i rëndësishëm strategjik i shoqërisë “ALBGAZ” Sh.a. do të jetë edhe anëtarësimi dhe bashkëpunimi me organizma dhe shoqata rajonale të fushës së gazit.

- Përbushja e detyrimeve që rrjedhin si pasojë e anëtarësimit të shoqërisë ALBGAZ Sh.a. në rolin e vëzhguesit në Shoqatën Europiane të Operatorëve të Transmetimit të Gazit (ENTSO-G),
- Angazhimi në aktivitetet në kuadër të Traktatit për krijimin e Komunitetit të Energjisë, duke marrë pjesë në Forumin e Gazit, në Grupin e Gazit për sigurinë e furnizimit, etj.

Së pesti: Një aspekt tjetër i rëndësishëm i shoqërisë “ALBGAZ” Sh.a. ka qenë ngritja brenda një periudhe 3 mujore dhe funksionimi i Këshillit Tekniko- Shkencor të shoqërisë. (si një Strukturë ad-hoc i përbërë nga ekspertë teknikienë që kanë kualifikim dhe ekspertizë të konfirmuar në fushën e gazit dhe të hidrokarbureve në tërësi), i cili do të ketë për objekt: Shqyrtimin dhe vlerësimin tekniko-shkencor duke përgatitur mendimin përkatës për programet, projektet, studimet si dhe marrëveshjet në fushën e gazifikimit dhe infrastrukturës së tij të transmetimit, shpërndarjes, depozitimit dhe GNL, të cilat përgatiten nga drejtoritë e shoqërisë “ALBGAZ” Sh.a. apo në bashkëpunim me institucione dhe subjekte konsulence.

Së gjashti: Një objektiv i rëndësishëm i shoqërisë “ALBGAZ” Sh.a., do të jetë edhe garantimi i financimit të aktivitetit të shoqërisë, dhe specifikisht për periudhën 2018 dhe 2019.

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafit 19 të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, ALBGAZ sh.a. si OST është në bashkëbisedime me ERE (nën vëmendjen e Zyrtarit të Përputhshmërisë), dhe ka kërkuar shtyrjen e afatit të dorëzimit të planit 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit deri me datë 31.10.2019 sipas Vendimit ERE Nr. 235, datë 2.11.2018.

4.2. Përjashtimi i sjelljes diskriminuese

Kushtet dhe procedurat përcaktohen në lidhje me ofrimin e Shërbimeve të Transmetimit të Gazit, për të parandaluar ndonjë trajtim diskriminues nga ana e OST.

Është konstantuar që ALBGAZ është në proces realizimi për përgatitjen e Kodin të Rrjetit të Transmetimit.

4.2.1. Aksesimi në sistemin e transmetimit

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve 22, 23, 24, 25, 26 të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, ALBGAZ sh.a. si OST i plotëson kërkesat e Programit duke marrë masa të sigurojë akses të barabartë dhe jo diskriminues.
- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafit 27 të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, Tarifat dhe detyrimet e tjera të ALBGAZ sh.a. janë: OST- është në bashkëbisedime me ERE (nën vëmendjen e Zyrtarit të Përputhshmërisë), dhe ka kërkuar shtyrjen e afatit të dorëzimit të planit 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit deri me datë 31.10.2019 sipas Vendimit ERE Nr. 235, datë 2.11.2018. Me vendim Nr. 97, Datë 23.04.2018 “ Mbi Miratimin e Tarifës së Transmetimit të Gazit Natyror nga Shoqëria ALBGAZ sh.a. për Vitin 2018”, ALBGAZ ka plotësuar detyrimet për shërbimet e OST.

4.2.2. Konkurrenca dhe marrëdhëniet komerciale

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafit 28 të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017 , aktivitetet e ALBGAZ sh.a. si OST nuk kanë ndikuar për të kufizuar konkurrencën e drejtë në tregun e gazit natyror.
- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve 29, 30, 31 të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, ALBGAZ sh.a. si OST i plotëson kërkesat e Programit.

4.2.3. Konflikti i interesit

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve 32, 33, 34, 35 të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, ALBGAZ sh.a. si OST i plotëson kërkesat e Programit.

4.3. Politika e informacionit të kompanisë OST

ALBGAZ sh.a. si OST ka ndërmarrë një sërë veprimesh për të siguruar informacionin, konfidencialitetin dhe transparencën ndaj publikut duke i ofruar akses të barabartë përdoruesve në të gjitha dokumentacionet që disponon pasi është e detyruar të publikojë në faqen zyrtare të korporatës, sipas kuadrit rregullator që rregullon veprimtarinë e saj.

4.3.1. Sigurimi i informacionit

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve 36, 37, 38 të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, ALBGAZ sh.a. si OST i plotëson kërkesat e Programit.

4.3.2. Konfidencialiteti i informacionit

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51 dhe nën pikat e tyre të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, ALBGAZ sh.a. si OST është në angazhim e sipër për të krijuar dhe implementuar një rregullore të brendshme të bazuar në këto kërkesa të Programit. Zyrtari i Përputhshmërisë së bashku me OST po draftojnë një rregullore të tillë dhe pritet që stafi të trajnohet nga Zyrtari i Përputhshmërisë mbi këto kërkesa.

4.3.3. Informacioni publik

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve 52, 53, 54 të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, ALBGAZ sh.a. si OST i plotëson kërkesat e Programit.

4.4. Zbatimi i Programit të Përputhshmërisë

Programi i Përputhshmërisë i miratuar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, është i krijuar i tillë që të ketë formën e një rregulloreje, apo udhëzimi me angazhime të detyrueshme për të gjithë drejtuesit dhe punonjësit, si dhe përfaqësuesit e autorizuar të ALBGAZ sh.a. si OST, siç janë audituesit, këshilltarët, kontraktuesit, pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit si dhe palët e tjera të treta.

4.4.1 Karakteri detyrues i Programit të Përputhshmërisë

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve 55, 58, 59 të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, ALBGAZ sh.a. si OST i plotëson kërkesat e Programit.
- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafit 56 të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, të gjithë drejtuesit dhe punonjësit e ALBGAZ sh.a. si OST si dhe përfaqësuesit e autorizuar dhe audituesit dhe këshilltarët janë të informuar për Programin dhe do ta zbatojnë atë.
- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafit 57 të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, ALBGAZ sh.a. si OST i plotëson kërkesat dhe Zyrtari i Përputhshmërisë udhëzon rregullisht mbi zbatimin programin, drejtuesit dhe punonjësit e rinj para fillimit të mandatit të tyre.

4.4.2 Monitorimi i zbatimit të Programit të Përputhshmërisë

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70, 71, 72 të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, ALBGAZ sh.a. si OST i plotëson kërkesat e Programit.

4.4.3 Raportimi për zbatimin e Programit të Përputhshmërisë

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve 73, 74, 75 të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, çdo vit, jo më vonë se data 31 Mars, Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të përgatisë dhe të dorëzojë tek ERE një raport për përputhshmërinë e OST me këtë Program, i cili duhet të publikohet (në dy gjuhë) në faqen e internetit të OST dhe të ERE.
Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të dorëzojë një raport të përgatitur referuar në Paragrafin 73 Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, ALBGAZ sh.a. si OST Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të raportojë rregullisht, me gojë ose me shkrim, te organet përkatëse korporative të OST në lidhje me zbatimin e këtij Programi.

PJESA E DYTË

5. Rekomandimet e Zyrtarit të Përputhshmërisë për zbatimin më korrekt të Programit të Përputhshmërisë

Ky kapitull përcakton masat, procedurat dhe rekomandime të ndryshme që synojnë të përmirësojnë Programin e Përputhshmërisë të ALBGAZ sh.a. si OST, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, të cilat janë propozuar nga Zyrtari i Përputhshmërisë që nga data e marrjes së detyrës dhe që është miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës në datën 16.10.2018. Këto rekomandime sugjerohen për një informim më të detajuar të stafit të OST për çështjet që kanë të bëjnë me përputhshmërinë dhe zhvillimin e programit të përputhshmërisë.

5.1. Përditësimi i faqes zyrtare të OST për të përfshirë Programin e Përputhshmërisë

Sipas kërkesave ligjore të përcaktuara në Ligjin Nr. 102/2015, datë 23.09.2015, “ Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar, si dhe kërkesat e Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të ketë një rubrikë të veçantë për Përputhshmërinë në faqen zyrtare të OST (www.albgaz.al). Aty do të publikohen raportet, rregulloret, dhe një pikë kontakti për ata që duan të marrin informacion mbi programin dhe të informojnë për programin.

5.2. Përmirësimi i Kodit të Etikës duke përfshirë dhe Programin

Kodi i Etikës aktual i përdorur nga OST është shumë i mirë por kërkon një përmirësim duke shtuar pjesë nga Programi i Përputhshmërisë i miratuar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017.

5.3. Manual Pune: Parimet e Programit të Përputhshmërisë

Zyrtari i Përputhshmërisë për vitin 2019 do të krijojë një udhëzim për katër parimet e programit. Ky udhëzim do shërbejë si dokument i brendshëm për të informuar punonjësit mbi Programin e Përputhshmërisë të ALBGAZ sh.a. si OST. Është shumë e rëndësishëm që të me anë të këtij udhëzimi të punonjësit të njohin dhe plotësojnë të gjitha kërkesat e Programit.

5.4. Kanal komunikimi me Zyrtarin e përputhshmërisë

Për të siguruar përputhshmërinë me programin duhet të krijohet një kanal komunikimi ndërmjet Zyrtarit të Përputhshmërisë, Stafit, klientëve, publikut, dhe përdoruesve të gazit natyror. Komunikimi ka për qëllim të sigurojë që Zyrtari i Përputhshmërisë të fitojë njohuri për të gjitha incidentet e mospërputhjes në lidhje me sjelljen jo etike ose të paligjshme (p.sh. konfliktet e interesit, zbulimi i informacionit komercialisht të ndjeshëm, trajtimi diskriminues i Përdoruesve të Sistemit, mosrespektimi i Programit të Përputhshmërisë), dhe që anonimiteti i personave që raportojnë këto incidente të jetë plotësisht i mbrojtur. Kanali i komunikimit realizohet në tre mënyra të ndryshme:

- me anë të plotësimit të formularit e dorëzimit elektronik nëpërmjet faqes së internetit të korporatës (www.albgaz.al),
- me postë,
- me e-mail (complianceofficer@albgaz.al),

5.5. Udhëzues për Politikat e klasifikimit të dokumentacionit

ALBGAZ sh.a. si OST duhet të krijojë një udhëzues për klasifikimin e dokumentacionit sipas kërkesave të Programit kapitulli B “Konfidencialiteti i informacionit”. Ky udhëzues mund të përfshihet tek Kodi i Etikës së OST. Zyrtari i Përputhshmërisë do jetë në bashkëpunim me OST për të përfunduar këtë rekomandim.

5.6. Përditësim/amendim i Programit 2019

Pavarësisht se Programi i Përputhshmërisë i miratuar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, është në vitin e parë të tij të aplikimit, do shikohet nga ana e Zyrtarit të Përputhshmërisë, OST, ERE, që të përmirësohet/amendohet, në rast se shihet e arsyetueshme që të jetë i përditësuar sipas kërkesave të KE pasi kërkesat ligjore mund të ndryshojnë dhe/ose shtohen. Ky rekomandim është momentalisht në proces.

5.7. Aplikacion/mekanizëm për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Programit të Përputhshmërisë.

Tek Buletini informativ do të shtohet një mekanizëm i huazuar nga Sistemi i Menaxhimit të Informacionit (MIS). Është një sistem teknologjik informacioni (TI) i përdorur për Vendim-marrje, për koordinim, kontrollim, analizim dhe vizualizim të informacionit në një organizatë, sidomos në një kompani. Ky sistem do të krijojë dhe draftohet nga Zyrtari i Përputhshmërisë së bashku me OST.

5.8. Paraqitja e teknikave të reja për trajnimet e stafit

Duke qënë se ALBGAS sh.a. si OST është shoqëri e re dhe tregu i gazit aktualisht inegzistent do të jetë në zhvillim, duhet që stafit ti paraqiten teknika të reja për trajnime mbi fushën e gazit, rregulloreve, direktivave, projekteve dhe të mbahen në informim të plotë për industrinë e gazit. Zyrtari i Përputhshmërisë do organizojë, njëtrajtësojë dhe të mbikëqyrë këtë etap si shtesë për stafin e OST, pasi ata trajnohen nga SNAM dhe/ose organizata të tjera.

PJESA E TRETË

6. Përfundime

Analiza e mësipërme përcakton se, në vitin 2018 (viti i parë i zbatimit të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017 “Mbi miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror”), ALBGAS sh.a. si OST ka filluar dhe vazhduar me zbatimin e Programit të Përputhshmërisë në mënyrë të saktë që nga dita e certifikimit të tij. Drejtuesit dhe Stafi i kompanisë, kanë ndjekur në masë të madhe kuadrin rregullator specifik.

Modeli OST dhe OSSH (Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror) i përzgjedhur nga OST, referuar Vendimit Nr. 848, datë 7.12.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e shoqërisë “ALBGAS” sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive “ALBPETROL” sh.a. dhe “ALBGAS” sh.a.”, është duke u zbatuar me sukses, në përputhje me kuadrin ligjor në përputhje me tregun e gazit.

Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë ALBGAS sh.a., me Vendimin Nr. 233 datë 16.10.2018, emëroi Z. Elvis Ponari MBA, MSc, në pozicionin e Zyrtarit të Përputhshmërisë të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST), me miratimin paraprak të Entit Rregullator të Energjisë sipas Vendimit Nr. 223, date 16.10.2018, “Mbi miratimin e "Kerkesave minimale per zyrtarin e perputhshmerise, kriteret profesionale si dhe kriteret e tjera perzgjedhese" dhe miratimin paraprak te zyrtarit te perputhshmerise se OST te gazit natyror”.

Gjatë vitit 2018 në funksionimin e shoqërisë ALBGAS sh.a. ka ndodhur një ndryshim i rëndësishëm përse ka të bëjë me ndryshimin e Autoritetit publik, që përfaqëson shtetin si pronar të 100% të aksioneve të shoqërisë ALBGAS sh.a., pasi referuar VKM Nr. 108, datë 23.2.2018, “Për një ndryshim në Vendimin Nr. 848, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e shoqërisë “ALBGAS” sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive “ALBPETROL” sh.a. dhe “ALBGAS” sh.a.””, është përcaktuar që Autoritetit publik, që përfaqëson shtetin si pronar të 100% të aksioneve të shoqërisë “ALBGAS” sh.a. do të jetë ministria përgjegjëse për infrastrukturën.

Në fushën e veprimtarisë së shoqërisë ALBGAS sh.a. që është sektori i energjisë, gjatë vitit 2018 janë miratuar edhe dy nga dokumentet më të rëndësishme për sektorin e energjisë dhe specifikisht të sektorit të gazit duke përfshirë direkt objektin e veprimtarisë së shoqërisë ALBGAS sh.a., që janë:

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë - 2018

- Miratimi i Strategjisë Kombëtare të Energjisë për periudhën 2018 – 2030, miratuar me Vendimin Nr. 480, datë 31.7.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë për periudhën 2018– 2030”.
- Miratimi i Master Planit të Gazit për Shqipërinë, miratuar me Vendim Nr. 87, datë 14.2.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”.

Mbi bazën e certifikimit të shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. filluar nga ERE me Vendim i Bordit të ERE Nr. 179, datë 8.11.2017 “Mbi certifikimin e shoqërisë Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror, ALBGAZ sh.a.”, ajo është licencuar si Operator i Transmetimit të Gazit Natyror me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 188, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë ‘ALBGAZ’ sh.a., në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, Vendim i cili gjatë vitit 2018 ka patur edhe një ndryshim nëpërmjet Vendimit të bordit të ERE-s Nr. 178, datë 20.8.2018.

Gjatë vitit 2018 shoqëria “ALBGAZ” sh.a. ka patur një aktivitet konkret përsa i përket rolit të saj si kompania publike e transmetimit të gazit, pasi gjatë këtij viti shoqëria “ALBGAZ” sh.a. ka hyrë në marrëdhënie bashkëpunimi me shoqërinë italiane SNAM S.p.A. për krijimin e shoqërisë së përbashkët “ALBANIAN GAS SERVICE COMPANY” sh.a., e cila ka nënshkruar me shoqërinë Trans Adriatic pipeline AG (TAP AG) një Marrëveshje për shërbimin e mirëmbajtjes së Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP) në teritorin shqiptar.

Investigimet që u kryen për periudhën e vitit 2018 nga 1 Janar 2018 – 31 Dhjetor 2018, u bazuan në aplikimin e kërkesave ligjore të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, në lidhje me kontrollin e shoqërisë, me menaxhimin e çështjeve rregullatore të përdoruesve të gazit natyror, duke përfshirë dhe

- zhvillimin e një Sistem Transmetimi Kombëtar për Shërbimet e Gazit Natyror;
- Marrëveshja e Ndërmarrjes së përbashkët (Joint Venture) "ALBGAZ" sh.a. dhe "SNAM SPA";
- Finalizimi i marrëveshjes së Mirëmbajtjes ndërmjet gazsjellësit TAP AG dhe shoqërisë së përbashkët "ALBGAZ" sh.a. dhe "SNAM SPA";
- Zhvillimi i planit të investimeve për 2018, si dhe zhvillimin e Planit 10 - vjeçar të Zhvillimit të Rrjetit;
- projektet për zhvillimin e Kodit të Rrjetit të gazit natyror për menaxhimin e përdoruesve të gazit natyror;
- marrëveshjet, alokimet dhe llogaritjen e tarifave të aksesit dhe përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit në Shqipëri si dhe tarifave të shërbimeve të ofruara nga operatori i rrjetit të gazit.

ALBGAZ sh.a. si OST gjithashtu për vitin 2018 parashikoi projekte të reja në lidhje me ngritjen e kapaciteteve (Grup pune me BERZH), si dhe trajnimin e stafit në kuadër të investimeve strategjike (Gas Masterplan), ku gazsjellësi TAP AG do ketë rol suportues në implementimin e projektit.

Është e rëndësishme të përmendet se në vitin 2018 nuk i është paraqitur asnjë ankesë OST nga përdoruesit lidhur me zbatimin e pasaktë të ligjeve në fuqi për gazin natyror.

Sidoqoftë, në disa raste ka patur vonesa në krahasim me afatet e sugjeruara nga Programi i Përputhshmërisë (shih Kapitullin 4.1.3 - Planit Dhjetëvjeçar të Zhvillimit të Rrjetit të rishikuar, deri më datë 31.10.2019 “Planit të zhvillimit të rrjetit për periudhën 2019 – 2028”, sipas Vendimit Nr. 235, datë 02.11.2018).

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë - 2018

Ka patur gjithashtu diskutim (shih Kapitullin 4.1.1) për të argumentuar përfaqësuesve të MIE-s në Këshilli Mbikëqyrës të kompanisë. rrethanat aktuale kur faktikisht kemi mosegzistencë të tregut të gazit në Shqipëri, konsiderohen se nuk ka çështje problematike referuar kushteve të vendosura në Vendimin ERE-s Nr. 179, datë 8.11.2017.

Ka patur mangësi/procedura të paplota (shih Kapitullin 4.1.1) për dokumentacionin që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka ALBGAS sh.a. si OST, për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar. Afatit i plotësimit të dokumentacionit dhe lejes mjedisore nga OST është shtyrë deri me datë 20.12.2019 sipas Vendimit Nr. 188, ERE, datë 10.11.2017.

Duhet theksuar që ALBGAS sh.a. si OST, nën dijeninë e Zyrtarit të Përputhshmërisë, është në komunikim të rregullt me ERE për plotësimin e kërkesave ligjore. Zyrtari i Përputhshmërisë është marrë me koordinimin e komunikimit me ERE, me autoritetet e tjera kompetente, pjesëmarrësit ose me palët e treta që kanë lidhje me zbatimin e këtij Programi.

Gjithashtu përgjatë vitit 2018 Zyrtari i Përputhshmërisë veçanërisht ka qënë përgjegjës për:

- monitorimin e zbatimit të këtij Programi të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, “Mbi miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror”.
- përpunimin e një raporti vjetor, ku përcaktohen masat e marra për zbatimin e këtij Programi dhe dërgimin e saj në ERE;
- raportimin në organet përgjegjëse korporative të OST dhe dhënien e rekomandimeve për këtë Program dhe zbatimin e tij;
- investigimin dhe raportimin tek organet përgjegjëse korporative të OST për çfarëdo shkelje të pretenduar në lidhje me zbatimin e këtij Programi, dhe paraqitjen e zgjidhjeve të propozuara për masat e nevojshme korrigjuese;
- investigimin e konfliktit ekzistues ose të mundshëm të interesit për drejtuesit dhe punonjësit e OST, ofrimi i konsultimeve për të parandaluar konfliktet e mundshme të interesit dhe korigjimin e konfliktit ekzistues të interesit, si dhe zgjidhjet që propozohen për masat e nevojshme korrigjuese;
- njoftimi i ERE për shkeljet në lidhje me zbatimin e këtij Programi;
- raportimi në ERE për marrëdhëniet tregëtare dhe/ose financiare midis OST dhe kompanive vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë e tyre;
- paraqitja e propozimeve për organet përgjegjëse të OST, sipas miratimit paraprak nga ERE në lidhje me planin 10-vjeçar për zhvillimin e rrjetit të transmetimit ose investimeve individuale në rrjetin e transmetimit;
- monitorimi i përputhshmërisë së OST me dispozitat e Ligjit Nr. 102/2015, datë 23.09.2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar, dhe këtij Programi të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, duke rregulluar konfidencialitetin në aktivitetet e kompanisë OST;
- monitorimi i ndryshimeve legjislativë dhe rregullatore në lidhje me aplikimin dhe zbatimin e këtij Programi;
- ofrimi i konsultimeve në lidhje me hartimin dhe miratimin e akteve të brendshme të kompanisë OST dhe pasqyrimi i ndryshimeve ligjore dhe rregullatore në këto akte;
- përgjigja e pyetjeve të drejtuesve dhe punonjësve të OST në lidhje me këtë Program;

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë - 2018

- udhëzimin e drejtuesve dhe punonjësve të OST për këtë Program Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të ketë të drejtën të marrë pjesë tek të gjitha takimet e organeve korporative të OST, tek takimet e drejtuesve ose punonjësve duke përfshirë edhe takimet funksionale. Drejtuesit përgjegjës dhe/ose punonjësit duhet të njoftojnë Zyrtarin e Përputhshmërisë për takimet e programuara ose jo.

Në të njëjtën kohë, Zyrtari i Përputhshmërisë paraqiti për herë të parë Propozimet/Rekomandimet për zbatimin më korrekt të Programit të Përputhshmërisë dhe kuadrit rregullator (shih Kapitullin 5) të OST, përditësimin e faqes online duke përfshirë Programin e Përputhshmërisë, dhe zbatimin të menjëhershëm të Udhëzuesit të Politikave të Klasifikimit të Informacionit sipas Programit.

Përpunimi i menjëhershëm dhe efikas i Zyrtarit të Përputhshmërisë për të gjitha çështjet që i përkasin fushëveprimit të kompetencave dhe detyrave të tij (p.sh. përmes monitorimit të vazhdueshëm të të gjitha zhvillimeve në tregun e energjisë dhe veprimeve të ndërmarra për të parandaluar, identifikuar dhe trajtuar aktivitetet që mund të shkelin kuadrin institucional që rregullon operacionet) ka përmirësuar kulturën e punës në çështjet e përputhshmërisë rregullatore, duke siguruar përmbushjen e të gjitha kërkesave për certifikimin e saj si Operator i Kombinuar i Gazit Natyror.

Si përfundim, duhet përmëndur bashkëpunimi i shkëlqyer ndërmjet Zyrtarit të Përputhshmërisë me të gjitha njësitë organizative të ALBGAZ sh.a. si OST si me Stafin, Drejtorëve, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, strukturat përkatëse të MIE, dhe Bordin e drejtoritë e ERE si pjesë e detyrave të tij.


Tiranë, 25.03.2019

Elvis Ponari, MBA, MSc

Zyrtari i Përputhshmërisë, ALBGAZ Sh.a

ANEKS A

Struktura organizative e ALBGAZ Sh.a.



Arbër AVRANI
 Administrator
 OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT NATYRORE
 ALBGAZ SH.A

